

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

**PROJEKTVENDIM**

Nr. \_\_\_\_/2018

**PËR DISA SHTESA E NDRYSHIME NË VENDIMIN Nr. 93/2017 TË KUVENDIT  
“PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE, ORGANIKËS DHE  
KLASIFIKIMIT TË PAGAVE TË PERSONELIT TË KOMISIONIT TË PAVARUR  
TË KUALIFIKIMIT”**

Në mbështetje të nenit 78 dhe nenit C të Kushtetutës, si dhe të neneve 18, pika 1, dhe 29 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit,

**K U V E N D I**

**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**V E N D O S I:**

Në tekstin e vendimit nr. 93/2017 të Kuvendit, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Pika II ndryshon dhe bëhet:

“II. Organika e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është sipas lidhjes nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”

2. Në pikën III fjala “e personelit” shfuqizohet.

3. Pas pikës III shtohen pikat si më poshtë:

“IV. Struktura e pagave dhe nivelet e pagave për çdo klasë/kategori page për pozicionet “Sekretar i Përgjithshëm”, “Drejtor Drejtorie”, “Specialist”, “Përkthyes”, “Koordinator” “Sekretar gjyqësor” dhe “Sekretar” është sipas përcaktimeve të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë.

V. Nëpunësit në pozicionet që lidhen me procesin e informatizimit të administratës publike përfitojnë shtesë për natyrë të veçantë pune mbi pagën mujore në masën dhe sipas kushteve të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë.

VI. Nëpunësit në pozicionet “Sekretar i Përgjithshëm”, “Drejtor”, “Përkthyes” “Koordinator” dhe “Specialist” në njësitë organizative të paragrafëve IV dhe V të lidhjes nr.1 bashkëlidhur këtij vendimi, përveç pagës mujore përfitojnë një shtesë për natyrë të veçantë pune në masën 20.000 (njëzetmijë) lekë në muaj.

VII. Nëpunësit në njësitë organizative të paragrafit VI të lidhjes nr.1 bashkëlidhur këtij vendimi, si dhe sekretari i Kryetarit, përveç pagës mujore përfitojnë një shtesë për natyrë të veçantë pune në masën 10.000 (dhjetëmijë) lekë në muaj.

VIII. Nëpunësit në pozicionet Specialist Arkivi, përfitojnë shtesë për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin sipas përcaktimeve të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë.

IX. Struktura e pagës, vlerat e pagave për çdo klasë page, si dhe përfitimet për kushtet e vështirira e të dëmshme të shëndetit për punonjësit mbështetës janë sipas përcaktimeve në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore.”

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**K R Y E T A R I**

**Gramoz RUÇI**

**ORGANIKA DHE KLASIFIKIMI I PAGAVE TË  
KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT**

| <b>Funksioni organik</b>                                                                       | <b>Klasifikimi i pagës</b>                       | <b>Numri</b> |
|------------------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------------------------|--------------|
| <b>I. KRYETAR</b>                                                                              | <b>G3*</b>                                       | <b>1</b>     |
| Sekretar                                                                                       | Sekretar në kabinetin e Kryetarit të Kuvendit ** | 1            |
| <b>II. KOMISIONERËT</b>                                                                        | <b>G3*</b>                                       | <b>(11)</b>  |
| <b>III. NJËSIA E SHËRBIMIT LIGJOR</b>                                                          |                                                  | <b>(24)</b>  |
| Këshilltarë juristë                                                                            | 80% e pagës G3*                                  | 12           |
| Këshilltarë ekonomistë                                                                         | 80% e pagës G3*                                  | 12           |
| <b>IV. SEKRETAR I PËRGJITHSHËM</b>                                                             | <b>I-a</b>                                       | <b>1</b>     |
| <b>V. DREJTORIA E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE<br/>DHE MARRËDHËNIEVE ME MEDIAN<br/>DHE PUBLIKUN</b> |                                                  | <b>(16)</b>  |
| Drejtor                                                                                        | II-b                                             | 1            |
| Specialist (sekretarie gjyqësore)                                                              | IV-a                                             | 6            |
| Specialist (për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve)                                          | IV-b                                             | 2            |
| Përkthyes                                                                                      | II-b                                             | 5            |
| Koordinator për median dhe marrëdhëniet me jashtë                                              | III-a                                            | 1            |
| Specialist (prirje me popullin)                                                                | IV-b                                             | 1            |
| <b>VI. DREJTORIA EKONOMIKE DHE<br/>E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE</b>                                |                                                  | <b>(11)</b>  |
| Drejtor                                                                                        | II-b                                             | 1            |
| Specialist (financë/buxhet)                                                                    | III-b                                            | 1            |
| Specialist (burimeve njerëzore)                                                                | III-b                                            | 1            |
| Specialist (IT)                                                                                | III-b                                            | 1            |
| Specialist (protokoll/arkiv)                                                                   | IV-b                                             | 3            |
| Magaziner                                                                                      | VII                                              | 1            |
| Punonjës pastërmimi                                                                            | III                                              | 2            |
| Shofer/korrier                                                                                 | VI                                               | 1            |
| Gjithsej                                                                                       |                                                  | <b>(65)</b>  |

Shënim:

\*Sipas ligjit "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"

\*\* Kategoria e pagës për sekretarin e Kryetarit është sipas VKM-së nr.187/2017